

VENDIM
Nr. 661, datë 10.10.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIM I BREGLIQENIT ME STRUKTURA PUBLIKE
REAKTIVE, ZADRA/MOL PANORAMIK DHE SHTIGJE KËMBËSORE
NATYRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikualifikim i bregliqenit me struktura publike reaktive, zadra/mol panoramik dhe shtigje këmbësore natyrore”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “Ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 566 610 (pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 566 610 (pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekësh, të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasurinë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE ,QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI
“RIKUALIFIKIM I BREGLIQENIT, ME STRUKTURA PUBLIKE REAKTIVE, ZADRA/MOL PANORAMIK DHE
SHTIGJE KËMBËSORE NATYRORE”

Nr.	Emër mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe shpronësimi	Çmimi	Vlera totale / lekë	Shënime Konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
				Ndërtesë	Objektit /m ²		
1	Ilmi Sina	8280	1/105/ND	30	18,887	566,610.0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale e shpronësimit						566,610.0	

Shënim.

1. Llogaritjet janë bazuar në shkresën e ZVRPP-së, Tiranë, nr. prot. 31360/1, datë 23.08.2017, nr. prot. 38517/1, datë 20.11.2018 dhe nr. prot. 38517/4, datë 24.12.2018.
2. Për ndërtesat, vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000 (i ndryshuar) dhe sipas çmimeve të EKB-së, për qytetin e Tiranës, të miratuara me udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave, vënë në dispozicion me shkresën nr. prot. 684, datë 27.3.2018.